



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:043039

Datë: 10.01.2019

Numri i dokumentit: 00202158

**P. nr.496/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. A. nga fshati D, Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë PP.nr.969/18 të datës 26.07.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **24.12.2018** në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, mbrojtësit av. D. D. si dhe të akuzuarit H. A., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **H. A.** nga fshati D., Komuna e Klinës, ku edhe banon, nga i ati D. dhe nëna M. e gjinisë K., data e lindjes .... në fshatin D., Komuna e Klinës, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, atë i një fëmije, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

**I.**

- se me dt. **11.07.2018** rreth orës **16:25** në pikën kufitare **Q. P., Komuna e Gjakovës**, pasi që është ndalur nga ana e policisë, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursore nr. 02/L-128, e duke e ditur se ka të bëjë me substancë narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, në automjet me targa të regjistrimit ....., ngjyrë hiri metalike, i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku, dhe atë një cigare “J.” në formë bari, ngjyrë e gjelbërt, e cila pas ekzaminimit të AKF Prishtinë, ka rezultuar të jetë narkotik i llojit K. (M.), në peshë neto prej 0.66 gramë +- 0.0001 gramë, substanca e sekuestruar gjendet në Stacionin Policor në Gjakovë.

**-me çka ka kryer veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 te KPRK-së.**

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,17,41,45, 46,73,74,75,76 dhe nenit 275/2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KP-së të akuzuarit i shqipton :

### **DËNIM ME GJOBË**

Me dënim me gjobë në shumën prej **200 (dyqind ) euro** ,të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, shpenzimeve procedurale të paguaj shumën e përcaktuar nga gjykata si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Gjykata bazuar në nenin 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7, të akuzuarit i shqipton masën e :

### **MARRJA E SENDEVE**

Konfiskohet substanca narkotike e llojit K. (M.) në sasi prej 0.66 gr. +\_0.0001 gram e sekuestruar me dt.11.07.2018, që është objekt i kësaj vepre penale

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore-DP në Gjakovë ,ka ngritë aktakuzën PP.nr.969/18 të dt.26.07.2018, kundër të akuzuarit H. A. nga fshati D., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 24.10.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Ismet Tofaj lexoi aktakuzën PP.nr.969/18 të dt.26.07.2018, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës por deklaroi se paraprakisht në rreshtin e parafundit të dispozitivit të aktakuzës ku ka të bëjë me peshën neto në vend të “0.56 gramë” duhet të jetë “0.66 gramë: +-0.0001 gramë.

I akuzuari H. A., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. D. D., e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer, premtoi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë, si dhe faktin se është hera e parë që kam rëndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, thekson se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe

favoret juridike te pranimit te fajësisë, dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari H. A. : se me dt. 11.07.2018 rreth orës 16:25 në pikën kufitare Q. P., Komuna e Gjakovës, pasi që është ndalur nga ana e policisë, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë nr. 02/L-128, e duke e ditur se ka të bëjë me substancë narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, në automjet me targa të regjistrimit ...., ngjyrë hiri metalike, i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku, dhe atë një cigare “J” në formë bari, ngjyrë e gjelbërt, e cila pas ekzaminimit të AKF Prishtinë, ka rezultuar të jetë narkotik i llojit K. (M.), në peshë neto prej 0.66 gramë +- 0.0001 gramë, e substanca e sekuestruar gjendet në Stacionin Policor në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Gjatë marrjes se vendimit mbi dënimin kundër te akuzuarit dhe llojit te tij ,gjykata vlerësojë te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara nga neni 73 te KPRK-së, te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i një fëmije, sjelljen e mire te akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar, pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur në gjykatë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme , gjendjen e dobët ekonomike , e të cilat rrethana ndikuan qe gjykata duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes se kësaj vepre penale ,rrezikshmërinë e saj ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit nga neni 74 te KPRK-ës dhe te akuzuarit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind ) euro, me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike e llojit K. (M.) në sasi prej 0.66 gr. +-0.0001 e sekuestruar me dt.11.07.2018, , që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 01.11. 2016.,u murr komform nenit 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 nenit 69 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale n të përcaktuara nga gjykata dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.496/18 më datë 24.12.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.